

Fuat Hajdini

Shef i kontabilitetit

Unë jom i lindun me 9 nëntor, '47-sh, fshati Zabel i Epërm, osht' ni fshat atje nalt. Fëmininë e kom kalue në Zabel, në fshatin e lindjes, e pastaj diku në moshën shtatë vjeçare, pa i mushë shtatë nashta, jom regjistruë në Komoran u konë shkolla fillore atëherë, "Jeta e Re", në Komoran osht' thirrë. Kemi udhëtu me moshatartë e mi po dihet për shkollë, pas dite kemi ardhë këtu, në këtë fshat ku jemi këtu, përpara i kemi thonë na fshati Kolonistav', se ka pasë serb, që kanë ardhën në '36-tën, e masanej jon kthye në '41-shin, janë ikë prej ktuhit, e në '46-shin prap jon kthye, disa jon kthye, e disa kanë pru edhe tjerë që u bo kolonizimi i Kosovës qatë kohë po dihet. E kjo lagje këtu, atëherë ka pasë veç serb, edhe na si fëmi ksajde, u dashtë me i ra ksajde kujdesshëm, kajherë u dashtë kur kena pasë frikë e sene me ia majtë pak ma rrotull që mos me kalu nëpër fshat të tyne, se majshin këta përveç të tjerave edhe gusa e rosa, e jon konë pak si t'rrezikshme, e na si fëmi ikshim prej tyne se na njekshin [*imiton zhurmën e rosave*].

N'fillore, në vjeshtë kemi ardhë na prej Zabelit në Komoran, jemi vendosë, edhe për mu tani ajo pjesë ka qenë ma e lehtë e fëminisë përderisa e kom pasë shkollën afër, normalisht. Edhe atëherë për atë kohë u konë aktuale përveç me mësue, m'u sjellë mirë e, ka qenë koha kur kanë pasë respekt ma shumë e...edukim nashta ma të mirë se sot. Në atë kuptimin po thom, se në thojza, po ka qenë kënaqësi, për shembull rrugës kur ki taku naj të moshun, naj të vjetër me përshëndetë "Mirëdita", "Mirëmrara", ajo u konë aktuale, po sigurisht në fshat.

<<< *Ambient i klasës në shkollë* >>>


Edhe normalisht që si nxanës jom konë i dallum, me mësime, gjithëherë kom kalue, në atë kohë i thojshim shkëlqyshëm me krejt pesa. Edhe kanë pasë fillue ni kohë, ni aktivitet prej klasës t'pestë e anena, m'u marrë me shkrime edhe fëmija ka pak, me shkallavitën, naj vjershë e sene. Unë e kom pasë fatin të mirë për atë kohë, e kom pasë shok të bankës Ymer Elshanin, kit' shkrimtarin për fëmi që osht', i Korroticës së Poshtme, shok të bankës. E ai diku në klasën e gjashtë ia ka nisë ma aktiv për me shkruë, e une i inspirumë prej tina edhe unë u munojsha kapak me shkru, po jo qaq. Po e kom pasë ata, si, si... jo detyrë të shkrime po praktike. Me fjalë tjera çdo të shtune çka shkrujke gjatë javës, me ni bllok, jon konë do farë blloka, si gjysë A që i thuhet, të matematikës, me katrorë, ai në ato shkrujke poezi, unë i lexojsha ato poezitë e tina. Edhe kur qëllojke naj poezi shumë e mirë i thojsha, "Qikjo Ymer osht' ma e keqja", e ai ma bojke, "A, i poshtë", ma ngjitke për qafe edhe më thojke, "Ku pe kupton", a din, domethonë ajo ish ma e mira. Kështu që deri në klasë të tetë, e kemi kry bashkë këtu, tani janë nda rrugtë.

Une pata shku në shkollë Ekonomike në atë kohë, e kom pasë drejtimin Administrativ, se harrova me përmen pak jom marrë edhe me muzikë e me aktrim, a din këto të fëmive që jon konë n'shköllë për festa të ndryshme të asaj kohe, përgatitshim shfaqje. Edhe kangë e, kangë me kor e, recitime, jom konë aktiv në qat' mesin e shokëve që jemi konë ma aktiv. Edhe masi e kreva shkollën fillore, provova me shku ne shkollë të Muzikës, po atëherë u konë serbisht

shkolla e Muzikës, edhe interesant 13 shqiptarë konkurumë, ni femën u konë e Kamenicës, edhe 12 mashkuj të regjioneve të ndryshme. Po unë sun u pranova aty, se s'kisha njerz sigurisht për kohën, kështu që u regjistrova në shkollë Ekonomike. Edhe në shkollë Ekonomike kom pasë respekt për shokë e, besa i afërt edhe për shokë, se na prej fshatit shkum në qytet atje, kushtet po dihet për kohën janë kanë të vështira, por në ato kushte u dashtë me mësu, besa edhe t'u frigue që mos nuk po mujmë me nxanë me mësu sa duhet. Pastaj e regjistrova fakultetin Ekonomik, prej drejtimit tem, se jemi konë drejtimi Administrativ, na ma shumë jemi përgatitë për fakultetin Juridik me fjalë të tjera, por ni shok i jemi, "A shkojmë në fakultet Ekonomik?", se prej matematikës kemi qëndru shumë mirë, thash, "Shkojmë", se s'ja prisha, se ata e kom pasë edhe si shok të idealit, të kohës. Është ky Bedri Prishtina tash, atëherë u thirrë Novosella, edhe u regjistrum me provim pranues, atëherë u konë matematikë edhe gjuhë shqipe, edhe u pranum në fakultet Ekonomik.

E kemi kry fakultetin Ekonomik, edhe masi e kreu fakultetin Ekonomik, pa lutje pa kurgjo, jom punësu qetu në Komoran, për shëf të kontabilitetit, se kishin nevojë, kështu që s'kish nevojë me bo lutje hiç. Kom punu dy vite këtu, prej këtuhit më kanë thirrë me shku me punu në komunë të Gllogovcit, me punu si Inspektor i Shërbimit të Ardhunave Shoqnore edhe shkova atje në kohë. Pastaj kom punu si sektretar për Ekonomi edhe Punë Komunale të Kuvendit prej 23 marsit '73-shit. Në dhjetor të '74-shit kom shku në shërbim ushtarak. Kur jom shku në shërbim ushtarak, grujën e kom pasë me tre fëmijë, se unë u martova herët, se qashtu kenë rrethanat, e fati. Edhe pas ushtrisë jom kthi prap në Kuvend këtu, edhe në Rilindje jom shku me 16 Janar, '78-shit. Edhe atje në Rilindje s'kom konkurue, po janë ardhë e më kanë thirrën, "A po vjen?", si profesor e kom pasë Ismail Berisha, ai jeton në Prishtinë tash, i anës së Dranocit të Deçanit, Nisan Kastrati, vjet ka vdekë i ndjeri, ata më thirrën edhe shkova në Rilindje. Domethonë ata kanë pasë nevojë për mu, unë shpreha gatishmëri edhe, kështu që prej 16 janarit '78, deri me 31 mars '84 kom punu në Rilindje.

<<< Ambient i punës në Rilindje >>>



Në foto: Fuat Hajdini

Nga arkivi personal i Fuat Hajdinit

Në Rilindje po të kallxoj jon kanë kushtet, për këtë pjesën e kullës po të flas, jon kanë ideale, se u kanë ndërtim i asaj kohe, i rrallë. Ka pasë klimatizim në atë kohë, edhe pse u kanë e lejume duhoni, aty nuk u dike që po pin duhon, i ka pasë ato farë thithëset. Pastaj verës për shembull, edhe pse ka qenë vapë e sene aty e kem pasë freski. I ka pasë si do zhardinjera me lule e sene, masanej ata vet punëtortë, sidomos shoqet e punës, edhe pse ka pasë personel që osht' marrë me ujitje të tyne, të luleve, po tani ja kanë nisë edhe vet punëtortë me iu nejtë gati, për mu kultivue, me bo me thirrë ato pastruset që janë kanë, "Bina ujë, se po na thahen", e sene. Ni pjesë ku kom punu une, qaty si shef i kontabilitetit, që jon kanë shërbimet e kontabilitetit, edhe ato lulet që janë kanë nëpër ato zhardinjera, s'e di jon kanë të ndame ato, aty u kanë me beton ajo pjesë. E qajo pjesa e dritës mes tyne, jon kanë zhardinjeret ku ka pasë lule, e tash ato lulet, punëtorët i kanë pasë lidhë mes veti me pej me sene, u kanë bo aty sikur nifarë dekori i pa porosit', pa mjeshtri. Po diçka u kanë bukur, shumë. E tavolinën e kom pasë në mes të atyne, ku i kom pasë zyret... se ni kat, në katin e dytë ku jemi kanë na shërbimi i kontabilitetit, ni kat aty u kanë i haptë, krejt, n'anën tjetër gjysma asajna, si në mes të asajna janë kanë liftat, katër lifta për mu ngjitë te pallati, se ajo kulla u kanë 16 kat, janë kanë katër lifta. Dy në njanën onë, dy në tjetrën, n'atë far pjese. Kështu që, kjo pjesa, në njon onë knenaj u kanë shërbimi i kontabilitetit, në onën tjetër jon kanë financat. Jon kanë kushtet ideale normalisht. Ato bankat e punës, ato tavolinat e punës jon kanë sikur me kanë naj sallë e fakultetit, përpara kur jom kanë në Ekonomik qashtu jon kanë, ato bankat kur u ulshim ka dy vet, e qashtu në tavolina të punës jemi kanë ka dy. Domethonë i kom pasë në ballë aty ku kom punu aty si shef unë, tre rena me banka deri në fund të objektit atje. Edhe në fund atje i kemi pasë dy asketa, maqina të kontabilitetit i kanë thonë ata që kanë punu, kjo punë në '78-shin kur kom shku. Në '79-shin i kom ble, si drejtor financiar e kom pasë Ismail Kastratin, rahmetlia, edhe i blejtëm këto,

kompjuterat e parë të *Olivetit*. Tash ata punëtorë që ishin mësu me punu me askota rezistojshin se ajo ish e re diçka për kohën, po me fjalë të tjera, kompjuterat e parë, në shërbim të kontabilitetit të asaj kohe, i kom ble unë, i kom shti në përdorim. Puna tani ma efikase, e sene, edhe qeshtu.

I kom pasën tre kontista, një billancist, punëtorë të posaçëm për mjete themelore, për shpenzime, për shtypshkronjë, me i përcjellë shpenzimet e shtypshkronjës, simbas reparteve e tjera, e tjera, edhe kështu. U konë puna e ndame, tani secili për punën e vet, çdo tre mujë u dashtë me... përveç konsultës ditore, e javore, bashkëpunimet e kontrollat që me shku puna marë e mirë e konsultimeve, çdo tre mujë u dashtë secili për analitikën e vet që e ka udhëheqë, m'u përgatitë, edhe me thirrë unë njo ka njo, për me m'u barazu me gjendjen normale sintetike që i kanë thonë në atë kohë, në kontabilitet. Edhe për m'u përgatitë me i bo llogaritë periodike, çdo tre mujë janë bo. Billanci përfundimtar ka pasë angazhim edhe ma të jashtëzakonshëm, u dashtë me punue punë ekipore, nashta 15, 16 vet deri në dy, tre të natës ka ndodhë edhe mëngjesi na ka nuanë në punë për me i kry me... me, në kohë, se janë kanë afatet e caktume. Me 28 shkurt u dorëzojshin billancet, për vitin paraprak, edhe atëherë mos me i kry me kohë ato punë, ka pasë ndëshkime ligjore e sene, po jemi konë të suksesshëm.



Mbrëmja e përvjetorit të Rilindjes, 12 shkurt 1979

*Në foto: nga e majta në të djathtë, Fuat Hajdini, Ali Krasniqi, Selman Olluri dhe Ibrahim Rrmoku
Nga arkivi personal i Fuat Hajdinit*

Ka pasë për shembull, punëtorë, u konë ni Naim Maqedonci, që ai s'kish nevojë në ato punë me nejtë, se puntë e veta i kish krye, edhe mujke me nejtë shlrë te shpija e vet, po ai vike aty, se ata e kom pasë si qysh me thonë, si sharki për atmosferë. U punojke atje, edhe kajherë në pauzë naj cigare, kanga në kupë të qiellit shkojke, po, për me kry punë.

Atë llogarinë për fund të dhanave që u dashtë, ajo ka zgjatë nashta ni mujë ditë, punë kështu, shumë e madhe, e lodhshme, por disponimi i madh për kohën, edhe shkojshin puntë mirë. Tani u du'ke në fund të marsit me dorëzu billancin e konsolidimit, tash krejt qito tetë organizata bazë të billancit që janë ba, me bo ni billanc komolativ, i kanë thanë bilanc konsultimi në Shërbim të Kontabilitetit Shoqnor [ofshanë] qeshtu.

E me thonë të vërtetën ajo ka qenë angazhim i madh, punë e madhe, por unë e kom pasë lehtë me punu, se e kom pasën nanën e fëmive shumë t'mirë. Kjo, osht' marrë me fëmijë, me edukim, me shkollim, me veshëmbathje, me ushqim, me sene, po une s'po muj me thanë nashta, babë i keq nashta, n'thojza po, bash, bash, sa u duftë me punu me fëmijë, unë s'kom mujtë me punu, se jom konë shumë, shumë i angazhumë me punë. E kjo krejt i ka kry puntë me fëmijë të vet, për veshëmbathje, nashta veç kur ka ardhë koha e librave, bashkë kemi dalë, edhe i kemi ble për shtator, se e kemi pasur rregull, në fund të gushtit para fillimit të vitit shkollor, me dalë me fëmijë. Ren qysh kanë ardhë, me i ble veshëmbathjet, për shtator, për kohë të vjeshtës, teshat adekuate, të mira, qysh kanë dashtë fëmija, e qysh i ka zgjedhë nana e tyne, unë veç me pagu normalisht, edhe për dimën u konë koha e posaçme, me veshëmbathje, me krejt. Kështu që ato punë i ka kry nusja jem, fati jem, që tash me gjashtë shtator i kena bo 53 vjet qe jemi bashkë.

Si e kom marrë punën po të tregoj, unë thash me 16 janar ja kom fillu punës, në '78, [mendohet] a p'i bjen qashtu? Po, në '78-shin, me 16 janar '78. Tash, unë jom shku në qat' kohën kur janë krye regjistrimet vjetore të pasunisë. Edhe hera parë që jom shku atje, jom shkue me ni punëtor temin, me ni Kemal Salihu i Ferizajit ka qenë, ai i ka udhëheqë mjetet themelore, Evidencën e Mjeteve Themelore. Edhe jom shku me to, me përcjellë qysh, ku janë qato, se më ka interesu qajo pjesë, që ai i kish në Evidencë. Hera e parë që jom shku te prodhimi, me pa aty, u konë e ndame pjesë-pjesë ajo shtypshkronja ku u konë, qysh u konë procesi teknologjik.

E tani prej Rilindjes, prap edhe atje jo me konkuru e sene, po më kanë thirrë shoktë me shku me punu në Dardani, në Ndërmarrje Tregtare me material ndërtimor. Aty kom shku në prill të '84-shit. Unë e kom përjetu shumë mirë po thom, bile kaniherë me shokë kur flas ose me familje e sene, kom gabu kur e kom lëshu Rilindjen, me nifar metafore thom, "E kom thy kamën kur e kom lëshu Rilindjen".

Se më thirrën me shku me ni ndërmarrje tjetër, drejtor i Bashkësisë Punuese, u mashtrova për ni copë bukë ma shumë. Të ardhnat ma të mira i kisha atje, dukshëm ma të mira se këtu ku isha shef kontabiliteti. Bile kurrë s'e harroj, shkova te ni Selatin Ajvazi, u konë drejtor i Bashkësisë Punuse pat ardhë prej Kurakovës, m'i thonë, me njoftu që prej kësaj date s'jam këtu, pe lëshoj Rilindjen, n'ata erdh Rexhai Surroi, i ndjeri, dej sa u përshëndetëm, edhe po i thot, tha "Drejtor", tha, "A ki dëgju", tha, "Fuati, pe lëshon Rilindjen", edhe m'u drejtu, "Pse, ku, ku po shkon?", p'i tregoj, thash, "Qështu, qështu, më kanë thirrë", i thash, "E kom ni shansë me shku në Dardani", thash, "Për drejtor i Bashkësisë Punuese", tha, "Sigurisht të ardhurat jon në pyetje", thash, "Po, drejtor për zoten". Ju drejtu atij Selatinit, ai që ish drejtor i jemi direkt, se ky u konë drejtor

gjeneral, tha, “Selatin, a ki mundësi” tha, “Me ia plotësu kushtet, për me nalë Fuatin?” - “Po na kem nevojë shumë, po...”, tha, “Që je i Zoti”, tha, “Që ja jep”, tha, “Rrogën sa ka me marrë atje”, tha, “Në ven”, tha, “Nalë”. Tha “Po, a e din qysh osht’ drejtor ksi puna jo, organet, e rregullorja, e të ardhurat e sene”.

Domethonë, me pas’ pasë, mundësi për shembull Rilindja n’atë kohë me m’i plotësu kushtet për nevoja të mija, se unë atëherë i kisha shtatë fëmijë, jo shkolla e sene me ni rrogë, e Ramizja (gruaja) e kish shkollën Ekonomike, po s’mujsha me punësu, se fëmijë shumë, secili moshën e vet, rrethin e vet, e sene, e me ni rrogë ish problem. Edhe kështu që e lëshova Rilindjen, gabova. Tani më ka metë marak, pse jom mashtrue e, e kom lëshue Rilindjen, seriozisht. Se ka qenë kolektiv i shnoshë për kohën, që shkon me vullnet në punë, me vullnet punon, se rrethi, bashkëpuntortë e sjellshëm, të mirë, cilësorë, kushtet e mira, shumë të mira, të punës. Qashtu mo kun s’ka.

Kujna i ka shku menja për shembull, që vjen koha që unë në Rilindje kur kom punue shef kontabiliteti, e kena pasë ni kiosk para Rilindjes, kah shkojshim në punë, tash edhe pse ke mujtë ti me marrë Rilindjen pa pagesë, une kurrë nuk kom hi në Rilindje, kur jom shku në punë në mëngjes pa e ble gazetën. E me kafen e mëngjesit me shfletue Rilindjen. Bile e kom pasë ni punëtor prej Gjakovës nifarë Bedri Isniqi, [qeshë] “Mas pari ja nisi”, thojke “Prej të mramtës”, se në fund u konë ajo e shpalljes e vogla, po edhe kush ka dekë a din, “Veç qeto”, thojke “Jon të vërteta”, “Prej këtuhit, e knej” thojke, “kurgjo s’osht’ e vërtetë”, bojke hajgare, po e ka pasë domethanjën e vet atë kohë. E që vjen koha tash, Rilindje hiç se hiç, po edhe këto gazetat, n’këto kushtet private që jon, mos me pasë gazetë me ble, po tash veç në internet me hi me lexu gazeta kujna i ka shku menja? Po kqyre koha, a din. Efekti kohë.